| <p>Për (LOT-3) Kërkesa 3 Të paraqitet stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesional. - Se paku 15 puntor te angazhuar Minimum 10 te trajnuar nga fusha per siguri dhe shendet ne pune nga nje kompani e licencuar nga Ministria e Punes dhe Mireqenies Sociale,per siguri dhe shendet ne pune.</p>                                                                                                                                                                                                       | <p>Për (LOT-3) Dëshmia 3 Lista e punëtorëve me para kontrata minimum 15 punëtorë ose me Liste të ATK-së,. Per 10 puntoret te trajnuar nga fusha per siguri dhe shendet ne pune te dokumentohet deshmi nga Ministria e Punes dhe Mireqenies Sociale,per siguri dhe shendet ne pune..</p>                                                                                                                                                                                                      |
| <p>Për (LOT -4) (LOT -6) &amp; (LOT -7) Kërkesa 3 Të paraqitet stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesional. - Stafi teknik (PUNONJËS) që do të kyçet në projekt -minimumi 10 punonjës</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | <p>Për (LOT -4) (LOT -6) &amp; (LOT -7) Dëshmia 3 Lista e punëtorëve me kontrata ose para kontrata minimum 10 punëtorë</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <p>Për (LOT-5) Kërkesa 3 Të paraqitet stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesional. - Stafi teknik (PUNONJËS) që do të kyçet në projekt - minimumi 20 puntorë ,minimum 15 punëtor duhet te jenë të çertifikuar për siguri në punë dhe te kene sigurim shendetesor nga nje kompani e sigurimeve para dates se publikimit te kontrates (për shkak të natyrës së rrezikshmërisë së punës ). Minimum 1 person të çertifikuar për drenazhim të dheut dhe për trajtimin e mbetjeve te rrezikshme inerte .</p> | <p>Për (LOT-5) Dëshmia 3 Lista e punëtorëve me para kontrata minimum 20 punëtorë ose me Liste të ATK-së,Kopja e çertifikatave per personat e çertifikuar . Per sigurim shendetesor te deshmohe me fature police te sigurimit me numer te kontrates .</p>                                                                                                                                                                                                                                     |
| <p>Për (LOT-9) Kërkesa 3 Stafi Teknik Profesional Operatori ekonomik duhet të ketë së paku 20 punëtorë, të trajnuar në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për ofrimin e trajnimeve në siguri dhe shëndet në punë.</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | <p>Për (LOT-9) Dëshmia 3 Të paraqitet lista e stafit teknik, prej minimum 20 (njëzet) punëtorësh, e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik (OE). Të paraqitet lista e punëtorëve nga ATK ose parakontratrat për këtë projekt. Për 20 punëtorët të prezantohen certifikatat e trajnimit në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, të lëshuara nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për ofrimin e trajnimeve në siguri dhe shëndet në punë.</p> |
| <p>Për (LOT-1) Kërkesa 4 Vlerësimi i riskut nga një kompani e licencuar nga MPMS</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | <p>Për (LOT-1) Dëshmia 4 Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë përmes një raporti,</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “N.T. „Fer-Petroll”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Pejës LOT 1 Ndërtimi i rrugës Pocest – Dobërdol LOT 2 Asfaltimi i rrugës Zagerëm – Lubeniq LOT 3 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Hidro Drin – Maja e Zezë LOT 4 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dushkajë LOT 5 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa I LOT 6 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karaga” me numër të prokurimit: “635-26-3347-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| siguri dhe shëndet në punë (SSHP) të licencuar nga MPMS, ose të ketë kontratë angazhimi me një person të tillë apo kompani të licencuar nga MPMS për kryerjen e punëve të Koordinatorit për siguri dhe shëndet në punë.                                                                                    | ofrojë kontratën e punës me koordinatoren për SSHP si dhe certifikatën e lëshuar nga MPMS. Në rast të angazhimit të një kompanie për shërbime të SSHP, të ofrojë kontratën ndërmjet OE dhe Kompanisë së angazhuar                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Për (LOT-3) (LOT-8)& (LOT-9) Kërkesa 5 Baza për prodhimin e betonit të licencuar nga KPMM, në pronësi apo marrëveshje për furnizim me beton me një OE të licencuar. Prodhuesi i betonit duhet të posedojë Leje mjedisore valide të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor.             | Për (LOT-3) (LOT-8)& (LOT-9) Dëshmia 5. Leja për aktivitete të veçanta, valide, e lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale apo marrëveshje për furnizim me beton me një operator të licencuar nga KPMM. Marrëveshja duhet të jetë për këtë aktivitet prokurimi dhe e nënshkruar ndërmjet palëve. - Leja mjedisore valide e lëshuar nga MMPH.                                                                                                                      |
| Për (LOT-2) (LOT-8)& (LOT-9) Kërkesa 6. Baza për prodhimin e asfaltit të licencuar, në pronësi apo marrëveshje për furnizim me asfalt me një OE të licencuar. Kërkesa 7. Gurëthyes i licencuar në pronësi apo marrëveshje për furnizim me zhavor (agregat) me një OE të licencuar.                         | Për (LOT-2) (LOT-8)& (LOT-9) Dëshmia 7,8 Licencat valide (të skanuara nga origjinali ose kopje e noterizuar) të lëshuara nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale apo marrëveshje për furnizim me asfalt, dhe zhavor me një operator të licencuar nga KPMM. Marrëveshja duhet të jetë e noterizuar – e nënshkruar ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit në prezencë të noterit.                                                                                          |
| Për (LOT -1) (LOT -2) (LOT -3) (LOT -4) (LOT -5) (LOT -6) (LOT -7) (LOT -8) & (LOT -9) Kërkesa 8 Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit, Pajisjet dhe mekanizmi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT. | Për (LOT -1) (LOT -2) (LOT -3) (LOT -4) (LOT -5) (LOT -6) (LOT -7) (LOT -8) & (LOT -9) Dëshmia 8 Lista e pajisjeve – mjeteve të punës që OE duhet të ketë të vetat apo të kontraktuara (apo me qira), të dëshmuhen me kopje të librezave, deklarata doganore. (me dud doganor) Të dëshmohej se pajisjet motorike janë të regjistruara dhe kanë sigurim valid- Kopja e librezave të pajisjeve. O.E të cilët nuk i kanë pajisjet e regjistruara eliminohen nga ky A.Ptë eliminohet. |

### III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

|                                                                                                                                    |                             |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------|
| Po <input type="checkbox"/>                                                                                                        | Jo <input type="checkbox"/> |
| III.3.1) Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar                                                          |                             |
| Nëse po, referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse                                                 |                             |
| III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve |                             |
| Po <input type="checkbox"/>                                                                                                        | Jo <input type="checkbox"/> |

## NENI IV: PROCEDURA

### IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

|                                                   |
|---------------------------------------------------|
| IV.1.1) Lloji i procedurës                        |
| <input checked="" type="checkbox"/> E hapur       |
| <input type="checkbox"/> E kufizuar               |
| <input type="checkbox"/> Konkurruese me negociata |

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “N.T. „Fer-Petroll”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Pejës LOT 1 Ndërtimi i rrugës Poçest – Dobërdol LOT 2 Asfaltimi i rrugës Zagerëm – Lubeniq LOT 3 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Hidro Drin – Maja e Zezë LOT 4 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dushkajë LOT 5 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa I LOT 6 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karaga” me numër të prokurimit: “635-26-3347-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

## RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

### LOT-8 – Kërkesa 2 – Staf i Profesional

#### 1. Gjeodet (Bachelor), me minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit

Komisioni ka konstatuar këto mospërputhje:

- Në Dosjen e Tenderit është kërkuar që për angazhimin e stafit të paraqitet **Kontratë ose Parakontratë në emër të projektit**. Operatori Ekonomik ka paraqitur Marrëveshje për Bashkëpunim Profesional, e cila nuk përbën kontratë apo parakontratë sipas kërkesës së DT dhe NJK.
- Marrëveshja e paraqitur nuk përmban elementet thelbësore të një kontrate pune, siç janë orari i punës, kohëzgjatja e angazhimit dhe paga, elemente të domosdoshme sipas legjislacionit në fuqi.
- Marrëveshja mban datën 03.07.2027, çka nënkupton se ajo fillon të prodhojë efekte juridike nga kjo datë dhe, rrjedhimisht, nuk mund të konsiderohet dokument valid në momentin e dorëzimit të ofertës.
- Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur **referenca apo dëshmi të tjera** që vërtetojnë minimumin prej 3 viteve përvojë pune pas diplomimit, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues.

#### 2. Inxhinier i Arkitekturës (Bachelor), me minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit

Komisioni ka konstatuar se:

- Në vend të kontratës ose parakontratës në emër të projektit është paraqitur vetëm Marrëveshje për Bashkëpunim Profesional.
- Marrëveshja nuk përmban elementet obligative të kontratës së punës (orari i punës dhe paga).
- Marrëveshja është me datë 03.07.2027, prandaj nuk mund të konsiderohet dokument valid për këtë procedurë.

#### 3. Inxhinier i Ndërtimtarisë/Konstruktiv (Bachelor), me minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit

Komisioni ka konstatuar se:

- Është paraqitur Marrëveshje për Bashkëpunim Profesional dhe jo kontratë apo parakontratë, siç kërkohet në DT dhe NJK.
- Marrëveshja nuk përmban elementet esenciale të kontratës së punës.
- Marrëveshja mban datën 03.07.2027.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “N.T. „Fer-Petroll”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Pejës LOT 1 Ndërtimi i rrugës Poçest – Dobërdol LOT 2 Asfaltimi i rrugës Zagerëm – Lubeniq LOT 3 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Hidro Drin – Maja e Zezë LOT 4 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dushkajë LOT 5 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa I LOT 6 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karaga” me numër të prokurimit: “635-26-3347-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

- Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur dëshmi valide që provojnë minimumin prej 3 viteve përvojë pune pas diplomimit, siç janë referenca, vërtetime nga punëdhënësi apo dëshmi nga Trusti.
- Nga dokumentacioni rezulton se kandidati është diplomuar më 22.11.2018, ndërsa CV-ja është nënshkruar gjatë vitit 2019. Nuk janë paraqitur dëshmi shtesë për përvojën profesionale pas kësaj periudhe, prandaj nuk provohet përmbushja e kriterit të kërkuar.

#### 4. Master i Shkencave në Xehetari, i specializuar për Shpim-Plasje

Komisioni ka konstatuar se:

- Është paraqitur Marrëveshje për Bashkëpunim Profesional në vend të kontratës ose parakontratës së kërkuar.
- Marrëveshja nuk përmban elementet obligative të kontratës së punës.
- Marrëveshja është me datë 03.07.2027.
- Kandidati Xhevdet Kastrati nuk ka dëshmuar specializimin e kërkuar në "Shpim-Plasje", sipas kërkesës së Dosjes së Tenderit.
- Nuk janë paraqitur dëshmi të mjaftueshme që vërtetojnë përvojën profesionale pas diplomimit. Edhe pse diploma është e vitit 2010, dokumentacioni i paraqitur nuk dëshmon përvojën e punës pas kësaj periudhe, ndërsa referencat nuk përmbajnë periudhat konkrete të angazhimit.
- Gjithashtu, mungon CV-ja profesionale, e cila është kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit.

#### 5. Master i Infrastrukturrës Rrugore, i certifikuar si NVM, me minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit

Komisioni ka konstatuar se:

- Është paraqitur Marrëveshje për Bashkëpunim Profesional në vend të kontratës ose parakontratës.
- Marrëveshja nuk përmban elementet e domosdoshme të kontratës.
- Marrëveshja është me datë 03.07.2027.
- Kandidatja Vlora Neziri nuk ka paraqitur referenca, vërtetime nga punëdhënësi apo dëshmi të tjera që provojnë minimumin prej 3 viteve përvojë pune.
- Mungon edhe Certifikata NVM, e kërkuar në Dosjen e Tenderit.

#### 6. Inxhinier i Ambientit, i certifikuar si NVM, me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit

Komisioni ka konstatuar se:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.T. „Fer-Petroll", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Pejës LOT 1 Ndërtimi i rrugës Poçest – Dobërdol LOT 2 Asfaltimi i rrugës Zagerëm – Lubeniq LOT 3 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Hidro Drin – Maja e Zezë LOT 4 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dushkajë LOT 5 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa I LOT 6 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karaga" me numër të prokurimit: "635-26-3347-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

- Është paraqitur Marrëveshje për Bashkëpunim Profesional dhe jo kontratë apo parakontratë.
- Marrëveshja nuk përmban elementet e detyrueshme të kontratës së punës.
- Marrëveshja është me datë 03.07.2027.
- CV-ja e kandidatit **Ibush Luzha** nuk është e nënshkruar, në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit.
- Nga CV-ja rezulton se kandidati është njëkohësisht i angazhuar si Profesor Asistent në UBT, në dy fakultete, në kompaninë e tij private **Golden Consulting Centre SH.P.K.**, si dhe si eksperti gjyqësor për mjedis. Duke marrë parasysh këto angazhime të deklaruara dhe natyrën e projektit, Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur dëshmi që provojnë disponueshmërinë efektive të kandidatit për realizimin e këtij projekti.

#### Aneksi 7 – Lista e Pajisjeve

Në Dosjen e Tenderit është kërkuar:

**Rimorkio për bartjen e makinerive me peshë bartëse minimale 36 ton (1 copë).**

Operatori Ekonomik V-SHEHU SH.P.K. ka paraqitur një gjysmë-rimorkio me targa 07-855-AX, me këto karakteristika:

- Pesha totale e lejuar: **40,000 kg**
- Pesha bartëse e lejuar: **32,000 kg**
- Pesha vetanake: **8,000 kg**

Komisioni konstaton se **pesha bartëse e lejuar prej 32 ton nuk e përmbush kërkesën minimale prej 36 ton**, të përcaktuar në Dosjen e Tenderit. Për rrjedhojë, kjo pajisje nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

#### Përfundim

Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të ofertës, Komisioni Rivlerësues konstaton se Grupi i Operatorëve Ekonomikë N.T. "Fer-Petroll" dhe "V-SHEHU" SH.P.K. nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e disa kërkesave të detyrueshme të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, për sa i përket stafit profesional dhe pajisjeve të kërkuara. Si rrjedhojë, këto mospërputhje përbëjnë mosplohtësim të kriterëve të kualifikimit të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.T. „Fer-Petroll", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Pejës LOT 1 Ndërtimi i rrugës Poçest – Dobërdol LOT 2 Asfaltimi i rrugës Zagerëm – Lubeniq LOT 3 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Hidro Drin – Maja e Zezë LOT 4 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dushkajë LOT 5 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa I LOT 6 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa II LOT 7 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa III LOT 8 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Sejnove – Gjorë pjesa II LOT 9 Asfaltimi i anekseve të rrugëve në fshatrat e Rugovës( Shtupëq i madh dhe Shtupëq i vogël ) me numër të prokurimit: "635-26-3347-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

| ZYRA E PROKURIMIT<br>KOMUNA E PEJËS                                                                                                                              |                                                                                                                                                                        |                                 |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------|
| NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES                                                                                                                   |                                                                                                                                                                        |                                 |
| <i>Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik</i>                                                                      |                                                                                                                                                                        |                                 |
| Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: : Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Pejës                                                                 |                                                                                                                                                                        |                                 |
| LOT 1 Ndërtimi i rrugës Poçest – Dobërdol                                                                                                                        |                                                                                                                                                                        |                                 |
| LOT 2 Asfaltimi i rrugës Zagerëm – Lubeniq                                                                                                                       |                                                                                                                                                                        |                                 |
| LOT 3 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Hidro Drin – Maja e Zezë                                                                                                   |                                                                                                                                                                        |                                 |
| LOT 4 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dushkajë                                                                                                        |                                                                                                                                                                        |                                 |
| LOT 5 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa I          |                                                                                                                                                                        |                                 |
| LOT 6 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa II         |                                                                                                                                                                        |                                 |
| LOT 7 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa III        |                                                                                                                                                                        |                                 |
| LOT 8 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Sejnove – Gjorë pjesa II LOT 9 Asfaltimi i anekseve të rrugëve në fshatrat e Rugovës( Shtupëq i madh dhe Shtupëq i vogël ) |                                                                                                                                                                        |                                 |
| Nr. i prokurimit <sup>1</sup>                                                                                                                                    | 635-26-3347-5-1-1                                                                                                                                                      |                                 |
| Nr i brendshëm                                                                                                                                                   | 635-26-033-5-1-1                                                                                                                                                       |                                 |
| Radhë                                                                                                                                                            | Lënda / grupi: LOT 1 Ndërtimi i rrugës Poçest – Dobërdol                                                                                                               | Çmimi total i ofertës (me TVSH) |
| 1.                                                                                                                                                               | Grup i Operatorëve Ekonomik NISI ING SH.P.K.; Valdrini sh.p.k,                                                                                                         | 541,111.11                      |
| Radhë                                                                                                                                                            | Lënda / grupi: LOT 2 Asfaltimi i rrugës Zagerëm – Lubeniq                                                                                                              | Çmimi total i ofertës (me TVSH) |
| 1.                                                                                                                                                               | „Lika Trade" Sh.p.k., 600026555                                                                                                                                        | 239,208.00                      |
| 2.                                                                                                                                                               | Grup i Operatorëve Ekonomik Agim Morina B.I.; ARBËRI -NS SH.P.K.                                                                                                       | 190,415.00                      |
| Radhë                                                                                                                                                            | Lënda / grupi: LOT 3 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Hidro Drin – Maja e Zezë                                                                                          | Çmimi total i ofertës (me TVSH) |
| 1.                                                                                                                                                               | " REA" SH.P.K., 600181135                                                                                                                                              | 492,000.00                      |
| Radhë                                                                                                                                                            | Lënda / grupi: LOT 4 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dushkajë                                                                                               | Çmimi total i ofertës (me TVSH) |
| 1.                                                                                                                                                               | Grup i Operatorëve Ekonomik Benita Company; Idriz Kurtbogaj B.I.; ASFALT GROUP SH.P.K.,                                                                                | 686,000.00                      |
| 2.                                                                                                                                                               | " Shkembj " Sh.p.k., 600143614                                                                                                                                         | 689,238.00                      |
| Radhë                                                                                                                                                            | Lënda / grupi: LOT 5 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa I | Çmimi total i ofertës (me TVSH) |
| 1.                                                                                                                                                               | " Shkembj " Sh.p.k., 600143614                                                                                                                                         | 604,709.00                      |

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.T. „Fer-Petroll”, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Pejës LOT 1 Ndërtimi i rrugës Poçest – Dobërdol LOT 2 Asfaltimi i rrugës Zagerëm – Lubeniq LOT 3 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Hidro Drin – Maja e Zezë LOT 4 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dushkajë LOT 5 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa I LOT 6 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karagaq" me numër të prokurimit: "635-26-3347-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

| Radhë | Lënda / grupi: LOT 6 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa II  | Çmimi total i ofertës (me TVSH) |
|-------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------|
| 1.    | Asfalti SH.P.K., 810416249                                                                                                                                               | 586,020.50                      |
| Radhë | Lënda / grupi: LOT 7 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa III | Çmimi total i ofertës (me TVSH) |
| 1.    | BK - CONSTRUCTION SH.P.K., 810746589                                                                                                                                     | 257,070.00                      |
| Radhë | Lënda / grupi: LOT 8 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Sejnove – Gjorë pjesa II                                                                                            | Çmimi total i ofertës (me TVSH) |
| 1.    | Grup i Operatorëve Ekonomik DOREARTI SH.P.K.; Lani-AL SH.P.K.,                                                                                                           | 795,068.28                      |
| 2.    | Grup i Operatorëve Ekonomik N.T. „Fer-Petroll; " V - SHEHU " SH.P.K.                                                                                                     | 693,999.65                      |
| Radhë | Lënda / grupi: LOT 9 Asfaltimi i anekseve të rrugëve në fshatrat e Rugovës( Shtupeq i madh dhe Shtupeq i vogel )                                                         | Çmimi total i ofertës (me TVSH) |
| 1.    | Granit SH.P.K., 810292847                                                                                                                                                | 463,045.00                      |

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

**KOMUNA E PEJES shpërblen me kontratë per:**

|                                                                                                                                           |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| LOT 1 Grup i Operatorëve Ekonomik NISI ING SH.P.K.; Valdrini sh.p.k, ne vlere totale te ofertës: € 541,111.11                             |
| LOT 2 Lika Trade" Sh.p.k.,, ne vlere totale te ofertës: € 239,208.00                                                                      |
| LOT 3 " REA" SH.P.K.,, ne vlere totale te ofertës: € 492,000.00                                                                           |
| LOT 4 Grup i Operatorëve Ekonomik Benita Company; Idriz Kurtbogaj B.I.; ASFALT GROUP SH.P.K.,, ", ne vlere totale te ofertës: € 59,778.80 |
| LOT 5 " Shkembj " Sh.p.k., ", ne vlere totale te ofertës: € 604,709.00                                                                    |
| LOT 6 " Asfalti SH.P.K.,, ", ne vlere totale te ofertës: € 586,020.50                                                                     |
| LOT 7 " BK - CONSTRUCTION SH.P.K., ", ne vlere totale te ofertës: € 257,070.00                                                            |
| LOT 8 Grup i Operatorëve Ekonomik DOREARTI SH.P.K.; Lani-AL SH.P.K., ", ne vlere totale te ofertës: € 795,068.28                          |
| LOT 9 Granit SH.P.K., ", ne vlere totale te ofertës: € 463,045.00                                                                         |

Data: 22.07.2026

Me Respekt  
Menaxheri i Prokurimit  
**MILOT GASHI**

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “N.T. „Fer-Petroll”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Pejës LOT 1 Ndërtimi i rrugës Poçest – Dobërdol LOT 2 Asfaltimi i rrugës Zagerëm – Lubeniq LOT 3 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Hidro Drin – Maja e Zezë LOT 4 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dushkajë LOT 5 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa I LOT 6 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karaga” me numër të prokurimit: “635-26-3347-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

## INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

### VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

### VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

### ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

### PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - N.T. „Fer-Petroll

#### **Arsyeja e eliminimit nr. 1 – Bachelor i Gjeodezisë – Autoriteti Kontraktues:**

Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se për Bachelorin e Gjeodezisë, OE nuk ka paraqitur kontratë ose parakontratë në emër të projektit, siç ishte kërkuar në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, por ka dorëzuar një Marrëveshje për Bashkëpunim Profesional. Sipas AK-së, marrëveshjes i mungojnë elemente bazë të kontratës, përfshirë orarin e punës dhe vlerën e pagesës, ndërsa ajo mban datën 03.07.2027, që sipas AK-së nënkupton se nuk ishte aktive në periudhën relevante të procedurës. Gjithashtu, AK ka konstatuar se OE nuk ka paraqitur referencë pune për të dëshmuar minimumin prej 3 viteve përvojë pune pas diplomimit, sipas kërkesës së DT-së dhe NJK-së.

#### **Pretendimi nr. 1 – Bachelor i Gjeodezisë – GOE-ankues:**

OE ankues kundërshton eliminimin lidhur me ekspertin Bachelor të Gjeodezisë. GOE, pretendon se Marrëveshja për Bashkëpunim Profesional e dorëzuar duhet të konsiderohet dokument ekuivalent me kontratën apo parakontratën, pasi sipas tij ajo dëshmon disponueshmërinë dhe angazhimin e ekspertit për realizimin e projektit. Për datën 03.07.2027 të shënuar në marrëveshje, GOE deklaron se bëhet fjalë për gabim teknik. Sa i përket referencave për përvojën e punës, ankuesi pretendon se ato nuk janë përfshirë gjatë skanimit të dokumentacionit dhe se AK ka pasur mundësi të kërkojë sqarime apo informacione shtesë. Gjithashtu, OE thekson se përvoja mund të dëshmohej edhe përmes dëshmisë së Trustit Pensional, të cilën pretendon se e ka bashkëngjitur.

#### **Përgjigje në pretendimin -1 ( e parë )**

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “N.T. „Fer-Petroll”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Pejës LOT 1 Ndërtimi i rrugës Poçest – Dobërdol LOT 2 Asfaltimi i rrugës Zagerëm – Lubeniq LOT 3 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Hidro Drin – Maja e Zezë LOT 4 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dushkajë LOT 5 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa I LOT 6 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karaga” me numër të prokurimit: “635-26-3347-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

**Kërkesa e autoritetit kontraktues lidhur për bachelorin e Gjeodezisë ka kërkuar që kërkesa të plotësohet sipas kërkesës si në vazhdim:**

**Kërkesa:**

3. Bachelor i Gjeodezisë, me minimum 3 vite përvojë pune – pas diplomimit

**Dëshmia e kërkuar dokumentare:**

për secilin anëtar të stafit duhet të dorëzohen këto dëshmi: Diploma universitare përkatëse (Bachelor ose Master); CV profesionale e nënshkruar; Certifikata licenca profesionale përkatëse, aty ku kërkohet; Certifikata NVM, për pozitat ku kërkohet; Dëshmi për përvojën e punës (kontrata pune ose parakontrat ne emer te projektit, referenca, vërtetime nga punëdhënësi ose dëshmi nga Trusti ). sipas viteve të kërkuara.

**SQARIMI:**

GOE-ankues në dëshminë e ofruar me ofertë, ka ofruar **marrëveshje bashkëpunimi**, për stafin - bachelor i gjeodezisë, poashtu data e lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit është me datë: **03.07.2026**.



Poashtu janë evidente edhe mungesa e elementeve të marrëveshjes së bashkëpunimit edhe vlera e pagesës dhe orarin e punës, edhe pse nuk është specifikuar në kërkesën e AK, forma e marrëveshjes së bashkëpunimit si një dokument i cili përmban marrëveshje me të drejta dhe detyrime dhe një akt juridik do të duheshin të jenë të pasqyruara.

Lidhur me çështjen se AK ka kërkuar Kontratë apo parakontratë, AK e ka specifikuar edhe emërtimin e lidhjes: Kontratë ose Parakontratë, kurse GOE ka ofruar marrëveshje. Në bazë të emërimit dokumenti nuk e ka emërtimin e njëjtë, megjithatë ka elemente brenda marrëveshjes që në mënyrë objektive bëhet fjalë për të njëjtin projekt, poashtu është specifikuar edhe pozita e bachelorit të gjeodezisë ku në mënyrë objektive vërtetohet se bëhet fjalë për të njëjtin projekt, mirëpo data e lidhjes së marrëveshjes paraqet efekt juridik se kur bëhet i plotëfuqishëm dokumenti dhe data e lidhjes së marrëveshjes është lidhur me datë: 03.07.2026, kurse hapja e ofertave ka qenë me datë: 22.06.2026 ku gjatë fazës së vlerësimit deri me datë 03.07.2026 marrëveshja nuk ka qenë në fuqi dhe në anën tjetër

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “N.T. „Fer-Petroll”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Pejës LOT 1 Ndërtimi i rrugës Poçest – Dobërdol LOT 2 Asfaltimi i rrugës Zagerëm – Lubeniq LOT 3 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Hidro Drin – Maja e Zezë LOT 4 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dushkajë LOT 5 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa I LOT 6 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karaga” me numër të prokurimit: “635-26-3347-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

kërkesa e AK ka qenë që stafi të ketë kontratë apo parakontratë, nënkupton se data e kontratës apo parakontratës duhet të jetë para datës së hapjes së ofertave, poashtu mungesa e deklaruar e pagesës paraqet dokument me elemente me mangësi dhe çdo kërkesë për sqarim apo modifikim mund të konsiderohet edhe si ndryshim material.

Kurse sa i përket pjesës së përvojës së punës për Bachelorin e Gjeodezisë GOE, e ka ofruar trustin pensional dhe i njëjti është valid sipas kërkesës së autoritetit kontraktues.

### **PRETENDIMI I PARË I GOE-ANKUES ËSHTË I PABAZUAR**

#### **Arsyeja e eliminimit nr. 2 – Inxhinieri i Ambientit - Autoriteti Kontraktues:**

Për Inxhinierin e Ambientit, z. Ibush Luzha, AK ka konstatuar se OE ka paraqitur Marrëveshje për Bashkëpunim Profesional në vend të kontratës ose parakontratës, e cila, sipas AK-së, nuk përmban elementet bazë të kontratës dhe mban datën 03.07.2027. Përveç kësaj, AK ka konstatuar se CV-ja e ekspertit nuk është e nënshkruar, ndonëse kjo ishte kërkuar në dokumentet e tenderit. AK ka marrë parasysh edhe faktin se nga CV-ja rezulton se eksperti është i angazhuar në UBT, në kompaninë Golden Consulting Center SH.P.K. dhe si ekspert gjyqësor për mjedis, duke vlerësuar se, për shkak të këtyre angazhimeve, nuk dëshmohet mundësia e angazhimit të tij edhe në projektin konkret.

#### **Pretendimi nr. 2 – Inxhinieri i Ambientit- GOE-ankues:**

OE ankues kundërshton arsyen e eliminimit lidhur me Inxhinierin e Ambientit, z. Ibush Luzha. Sipas ankuesit, mungesa e nënshkrimit në CV është mangësi formale, e cila nuk ndikon në kualifikimet, përvojën apo disponueshmërinë e ekspertit. Ankuesi pretendon se këto elemente janë dëshmuar përmes dokumenteve të tjera të ofertës. Po ashtu, kundërshton konstatimin e AK-së se angazhimet e ekspertit në UBT, në kompaninë e tij dhe si ekspert gjyqësor e pamundësojnë angazhimin në projekt, duke argumentuar se legjislacioni nuk e ndalon një person të jetë i angazhuar te më shumë se një punëdhënës.

#### **Përgjigje në pretendimin -2 ( e dytë)**

Kërkesa e autoritetit kontraktues lidhur me inxhinierin e ambientit është:

#### **Kërkesa:**

6.Inxhinier i Ambientit, i certifikuar si NVM, me minimum 5 vite përvojë pune – pas diplomimit.

#### **Dëshmia e kërkuar dokumentare:**

Për secilin anëtar të stafit duhet të dorëzohen këto dëshmi: Diploma universitare përkatëse (Bachelor ose Master); CV profesionale e nënshkruar; Certifikata licenca profesionale

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “N.T. „Fer-Petroll”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Pejës LOT 1 Ndërtimi i rrugës Poçest – Dobërdol LOT 2 Asfaltimi i rrugës Zagerëm – Lubeniq LOT 3 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Hidro Drin – Maja e Zezë LOT 4 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dushkajë LOT 5 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa I LOT 6 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohove, Karaga” me numër të prokurimit: “635-26-3347-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

përkatëse, aty ku kërkohet; Certifikata NVM, për pozitat ku kërkohet; Dëshmi për përvojën e punës (kontrata pune ose parakontrat ne emer te projektit, referenca, vërtetime nga punëdhënësi ose dëshmi nga Trusti ). sipas viteve të kërkuara.

#### **SQARIMI:**

Lidhur me çështjen se AK, ka kërkuar Kontratë apo parakontratë, AK e ka specifikuar edhe emërtimin e lidhjes: Kontratë ose Parakontratë, kurse GOE ka ofruar marrëveshje. Në bazë të emërimit dokumenti nuk e ka emërtimin e njëjtë, megjithëatë ka elemente brenda marrëveshjes që në mënyrë objektive bëhet fjalë për të njëjtin projekt, poashtu është specifikuar edhe pozita e **Inxhinierin e Ambinetit**, ku në mënyrë objektive vërtetohet se bëhet fjalë për të njëjtin projekt, mirëpo data e lidhjes së marrëveshjes paraqet efekt juridik se kur bëhet i plotëfuqishëm dokumenti, dhe data e marrëveshjes e lidhur është me datë: 03.07.2026 kurse hapja e ofertave ka qenë me datë: 22.06.2026 ku gjatë fazës së vlerësimit deri me datë 03.07.2026 marrëveshja nuk ka qenë në fuqi dhe në anën tjetër kërkesa e AK ka qenë që stafi të ketë kontrat apo parakontratë, nënkupton se data e kontratës apo parakontratës duhet të jetë para datës së hapjes së ofertave, poashtu mungesa e deklaruar e pagesës paraqet dokument me elemente me mangësi dhe çdo kërkesë për sqarim apo modifikim mund të konsiderohet edhe si ndryshim material.

Lidhur me çështjen e nënshkrimit të CV -së, për Inxhinierin e Ambinetit se nuk është nënshkruar, sqarohet se kërkesa e AK lidhur me CV, është: **CV profesionale e nënshkruar;** .

